

PRANUAR ME: 07/08/2026
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO: 02/249



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së- IV- (katër) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajtë në sallën e seancave të Kuvendit Komunal të Malishevës më datën 22.07.2026 prej orës 09:30.

Në takim morën pjesë: Kryesusi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi, Zyrtar ligjor z.Muharrem Morina si dhe përfaqësues nga Zyra e Informimit z.Artan Paçarizi .

Kryesusi i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj: Përhëndetje për të gjithë. Mirë se keni ardhur në takimin e katërtë urgjent të KPF-së dhe për këtë takim kemi këtë rend të ditës:

R E N D I D I T Ë S

1. Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2026.
2. Kërkesa e Kryetarit.
3. Kërkesat e qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit e hedhi në votim rendin e ditës.

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Komitetit të KPF-së konstatoi se u miratua unanimisht nga anëtarët e komitetit për politikë dhe financa rendi i ditës.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2026.

Kryesus i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj:Fjalën ja kalojë Drejtorit për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Përsëndetje për të gjithë,sot do të prezentoj para juve raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2026,të njejtin material e keni edhe ju që janë të specifikuar në formë tabelare të gjitha kategoritë.

Sipas të dhënave të prezantuara në tabelat përkatëse del se K-Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin fiskal 2026,në shumën prej 22,088,710.00€ për të gjitha programet dhe nënprogramet.Kësaj shume i shtojm shumën 1,141,78€ donacione të vogla,del se buxheti i fituar në SIMFK si,buxhet përfundimtar kap shumën prej 22,089,851.78€.

Buxheti i alokuar për këtë periudhë(Janar-Qershor 2026),kap shumën prej 15,296,581.99€ çka do të thotë se shkalla e realizimit (alokimit) të buxhetit,në këtë periudhë është 69,24%.

Sipas shënimeve nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar(alokuar) për periudhën Janar-Qershor 2026 është $(13,272,605.55/15,296,581.99) \times 100 = 89.76\%$.

Sipas buxhetit për vitin fiskal 2026,nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mbledhen 1,943,948.00€.

Plani i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën Janar-Qershor 2026,është:559,584.53€ të hyrat e rregullta.Këto të hyra janë futur në sistem dhe janë alokuar,kurse të hyrat të cilat arkëtohen nga gjobat e gjykatave 11,296.00€ si dhe gjobave në trafik 125,036.20€ për periudhën TM1-ndërsa për periudhën TM-2 deri në përpilimin e raportit ense nuk ka ardhur.

Kryesus i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor për prezentimin.E hedhi në votim.Kush është për?

Rezultati i votimit:6 për,0 kundër.0 abstenim.

Kryesuesi i Komitetit të KPF-së konstatoi se u miratua unanimsht raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2026 si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës:Kërkesa e Kryetarit.

Kryesus i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj:Fjalën ja kalojë z.Muharremit.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Kryetari e ka një kërkesë për me hap një rrugë për shkak që gjatë vërshimeve atmosferike po hasin në vështirësi të mëdhaja në kanalizim dhe ujërat e zeza,komuna nuk po ka mundësi me depërtuar për shkak që qytetari i asaj prone e ka bllokuar kalimin e rrugës.Sot në Kuvend duhet me shqyrtuar kërkesën me të cilën e kanë sjellur sot Drejtoria për

Gjeodezi dhe Kadaster me shpallur zonë me interes të përgjithshëm publik sipërfaqën prej 307 m², prona i merret palës pastaj vendos nëse pajtohet me ju shpronësuar prona me mjete financiare apo me këmbim të pronës, e rëndësishme është që me u marrë ajo parcellë pastaj me futur kanalizimin për shkak që ajo po paraqet probleme të mëdhaja, madje Gjykata na ka denuar për shkak që ujërat e zeza kanë dalur nga sipërfaqja dhe ju ka depërtuar nëpër në disa biznese.

Kryesuesi i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj: Kërkesa e Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik në sipërfaqe prej 307 m² në parcellën 829/1 zona kadastrale në Malishevë. Kush është për që të rekomandohet për Kuvend?

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit të KPF-së konstatoi se u miratu unanimisht si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim kërkesa e Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik në sipërfaqe prej 307 m² në parcellën 829/1 zona kadastrale në Malishevë.

Muharrem Morina (Zyrtar ligjor): Pastaj e kemi Raportin e Eko-Regjionit i cili ka kërkuar me i ngritur tarifat për shkak të ngritjes së kostove të shërbimeve. Kryetari e ka themeluar një komision me këtë përbërje: Naser Morina Kryesuesi i Komisionit, Fadil Shala anëtarë dhe Sejdi Paçarizi themelues i kompanisë këta kanë propozuar që të votohet në Kuvend ndryshimi i tarifave ka qenë 5 € është ngritur tarifa në 7.50 € për shkak që është rritur kostoja e shërbimeve si për shembull që është ngritur çmimi i naftës. Tarifa caktohet me vendim të Kuvendit.

Kryesuesi i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj: Kush është për që Raporti i Eko-Regjionit për ngritjen e tarifës të rekomandohet në Kuvend?

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se miratohet unanimisht Raporti i Eko-Regjionit për ngritjen e tarifës si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Muharrem Morina (Zyrtar ligjor): I kemi edhe dy kërkesa të MAPL-së që kanë me hyrë në procedurë për shfuqizim si dhe një kërkesë e palës me të cilën ka kërkuar me ju kompenzuar prona e cila ju ka marrë. Shfuqizimi i vendimit nr 02163 për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës për ndërtimin e qendrës ditore për të moshuarit, kuzhinë humanitare dhe qendër për familjet në nevoja të veqanta shëndetësore. Shfuqizimi i komisionit për dhënie në shfrytëzim që ka qenë. Kërkesa me numër të protokollit 02/57 e parashtruar nga z.Sami Kastrati dhe Mustafë Kastrati.

Kryesuesi i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj: Kush është për që të rekomandohen për Kuvend kërkesat e lartëcekura.

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Komitetit të KPF-së konstatoi se u miratuan unanimisht kërkesat e lartëcekura si dhe i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës:Kërkesat e qytetarëve.

Kryesus i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj:Ne i kemi pranuar katër kërkesa të cilat janë të diagnostifikuar me kancer,por meqenëse ne sot kemi shtuar shumë pika që kemi me i trajtur në Kuvend ne këto kërkesa do ti trajtojmë një herë tjetër.

Kryesuesi i Komitetit të KPF-së z.Fatmir Ademaj i përfundoi punimet e mbledhjes në ora 10:00.

Malishevë,Korrik
22.07.2026

Procesëmbajtsja

Fatlume Delija



Kryesus i Komisionit

Fatmir Ademaj

